

FEMART FESTIVAL
EDICIONI I 8-TË

RAPORTI NARRATIV

FESTIVALI NDËRKOMBËTAR I ARTISTEVE DHE AKTIVISTEVE

SOLIDARITET DHE QËNDRUESHMËRI



15-20 TETOR, 2020
PRISHTINË, KOSOVË

© Qendra për Art dhe Komunitet - Artpolis - 2020

Dizajn: komitetistudio



FEMART FESTIVAL
EDICIONI I 8-TË

SOLIDARITET DHE QËNDRUESHMËRI
15-20 TETOR, 2020 PRISHTINË, KOSOVË

organizuar nga
organized by:

artpolis 
art and community center

PËRMBAJTJA

	FESTIVALI FEMART	6
	FESTIVALI FEMART NË ETNO FEST	8
	EKSPOZITA “AKTI I MBRËMJES	9
	KONCERTI – ANSAMBLI “ZANAT	10
	PUBLIKIMI I RAPORTIT & KONFERENCË “DREJT SOLIDARITETIT DHE BASHKËPUNIMIT	11
	PODKAST & DISKUTIM “FEMINIZËM, MENINIZËM A HUMANIZËM”	12
	PERFORMANCË “A JE ÇIKË, A DJALË!? PREMIERË – PRODUKSIONI ARTPOLIS	12
	PUNËTORI “ MËSIMET NGA ZED”	13
	PODKAST “ E ÇKA KE TI? ASI A KSI? HOMO, HETERO DHE GJITHÇKA NË MES E JASHTË TYRE”	14
	PODKAST “PENISI, VAGINI DHE KREJT TJERAT: MËSIMET E BIOLOGJISË QË S’U DHANË KURRË”	14
	EKSPOZITË “NË PËRQAFIM ME ZZ	14
	”SHFAQJE TEATRALE : “TRI MOTRAT & NATASHA P.	15
	”PODKAST “A BON ME T’PREK?	16
	PERFORMANCË & DISKUTIM “ SILVER BOOM” (FESTIVALI HAPU NË FEMART”	18
	SHFAQJE TEATRALE “TI, JAM UNË” PREMIERË – PRODUKSIONI ARTPOLIS	18
	FORUM DANS TEATËR “Ç’FARË DUAN BURRAT!?” PREMIERË – PRODUKSIONI ARTPOLIS	19

PUNËTORI “COVIDIA DELL’ARTE”	20
PODKAST “MËSIMI 1: QYSH ME E DASHTË VETËN QË ME E DASHTË EDHE TJETRIN”	20
FILMAT E REGJISOREVE KOSOVARE & PANEL DISKUTIMI	21
PERFORMANCË BALETI “LIDHMË MUA”	24
PODKAST “ ME NJI LULE S’QEL PRANVERA: ME KËMBË E DURË, BASHKË E PËRPARA”	25
PUBLIKIM BROSHURE & PANEL DISKUTIMI “ARTIVIZMI” – ARTI DHE SOLIDARITETI NË KOHË PANDEMIE	25
PERFORMANCË “T’U E MARRË “FUQINË” N’PYETJE” PREMIERË PRODUKSIONI ARTPOLIS	27
SHFAQJE MUZIKORE “ZGJIMI I PRANVERËS”	27
AFTER PARTY	29
SHËNIM RRETH COVID-19	30
STATISTIKAT E FESTIVALIT FEMART	31
DONATORËT	

Festivali FemArt: Për herë të tetë Qendra për Art dhe Komunitet – Artpolis organizoi festivalin ndërkombëtar për artiste dhe aktiviste – FemArt.

Këtë vit FemArt ishte pjesë e festivalit EtnoFest, ku në bashkëpunim realizuan “FemArt në EtnoFest” me datë 25 shtator, 2020 në fshatin Kukaj, kurse edicioni i 8-të i festivalit FemArt u realizua me 15-20 Tetor, 2020 (6 ditë) në Prishtinë.

FemArt si çdo vit edhe këtë edicion ka përmbushur misionin e vet, duke krijuar një hapësirë të sigurt dhe mikpritëse për gratë artiste për të treguar artin e tyre, të frymëzuar nga temat sociale dhe të drejtat e njeriut në rajonin e Ballkanit.

Moto e festivalit FemArt 2020 – Edicioni i 8të ishte “Solidaritet dhe Qëndrueshmëri”.

Solidariteti si parim i mbështetjes së ndërsjellë në mes grave dhe vajzave, artisteve dhe aktivisteve që punojnë për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave. **Qëndrueshmëria** si aftësi për t'i bërë ballë fatkeqësive, traumave dhe sfidave duke u ngritë në këmbë sa herë rrëzohemi e duke e ngritë zërin sa herë që mundohen të na heshtin.

Festivali përdoret si një platformë për iniciimin dhe paraqitjen e ideve dhe krijimeve që sjellin përpara konceptet feministe dhe zhvillimin e tyre në Kosovë, si dhe avokimin e të drejtave të barabarta dhe ndërtimin e paqës në rajon.

Koncepti dhe formati i festivalit FemArt këtë edicion ka ndryshuar si rezultat i përballimit me COVID-19. Në solidaritet dhe përkrahje FemArt ka sjellë krijime artistike origjinale nga artistet dhe aktivistet e vendit.

Festivali FemArt njihet për angazhimin dhe përkrahjen e të rinjve dhe të rejave, këtë vit 10 vullnetare/ë kishin mundësinë të ishin pjesë e festivalit, duke kontribuar në organizimin dhe mbarëvajtjen e tij, njëkohësisht FemArt ndihmoi në rritjen e aftësive të tyre kulturore të menaxhimit, profesionale por edhe rritjen e tyre personale, duke krijuar miqësi të reja e momente të bukura.

Vullnetarët e festivalit FemArt vinin nga komunitete dhe qytete të ndryshme, por të gjithë me një të përbashkët, dashurinë për artin dhe gatishmërinë për të bërë ndryshime sociale. Në fund të festivalit ata u certifikuan për shfaqjen e gatishmërisë, përkushtimit, përpjekjes së palodhur dhe rolit të vlefshëm si vullnetarë.

Të gjitha këto ngjarje të fuqishme dhe frymëzuese u zhvilluan në: Fshatin Kukaj, Teatri Oda, Teatri Kombëtar, Kino Armata, Galeria e fakultetit të arteve si dhe Sheshi Skënderbeu.

Programi i festivalit ka përfshirë temat: të drejtat e njeriut, të drejtat LGBTQI, fuqizimi i grave dhe vajzave, shkëmbimi i përvojave të suksesshme në rajon, procesin e vendimmarrjes së grave, dhuna në baza gjinore e shumë të tjera.

Festivali paraqiti krijime origjinale artistike të krijuara nga gratë nga Kosova dhe rajoni. FemArt ka prezantuar gjithsej 27 aktivitete, prej të cilave 7 prej tyre kanë qenë të lidhu-





ra dhe janë prezantuar edhe live në facebook. Femart ka prezantuar 6 performanca teatrale (4 premiera të cilat kanë qenë produksion i Artpolis-it), 2 ekspozita, 2 koncerte, 2 dans teatër, 1 performancë në ambient të hapur, 1 konferencë, 3 panele diskutime, 1 publikim i raportit, 1 publikim i broshurës, 3 punëtori, 10 filma të shfaqur (disa prej tyre premierë në Kosovë) si dhe 6 podcast, për Femart kanë raportuar rreth 50 media, si: Kids of Kosova për Femart citon “FemArti është festival feminist i njohur ndërkombëtarisht, i cili ka arritur që përmes artit të mirë dhe kualitativ të krijuar nga artistet dhe aktivistet të fuqizojë gratë dhe vajzat në njohjen e të drejtave të tyre të plota me qëllim të arritjes së barazisë politike, ekonomike, kulturore, personale, dhe shoqërore”.

Për Femart gjithashtu edhe Kultplus ka raportuar “Ky vit i vështirë ka shkaktuar shumë ndryshime në plane, për festivale dhe organizime tjera të ndryshme, për shkak të pandemisë Covid-19, përderisa FemArt pas një pune të madhe dhe me sfida, në këtë edicion të jashtëzakonshëm, do të jetë festivali i parë i organizuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me publikun në vitin 2020 në Kosovë dhe do të përfshijë më së shumti artiste/ë vendor sesa ndonjë edicion tjetër i FemArt-it deri tani”.

FEMART NË ETNO FEST – SOLIDARITET DHE QËNDRUESHMËRI – 25.09.2020

FemArt u prezantua me shfaqjen skenike “Gjuetaret e Artemidës” nga Zana Hoxha dhe ekspozitën e pikturave “Holocaust” nga Mirjeta Qehaja me datë 25.09.2020 në festivalin Etno Fest – edicioni i 10-të.

Emocionet e bukura dhe ngazëllimi ynë u kurorëzua me mirënjohje nga publiku por edhe nga festivali Etno Fest 10, me çmime nga juria profesionale:

1. Shfaqja më e mirë: “Gjuetaret e Artemidës”
2. Performanca më e mirë: “Gjuetaret e Artemidës”



Shfaqja skenike “Gjuetarët e Artemidës”: Inspiruar nga natyra dhe bukuritë e saja të fshatit Kukaj, aty ku hapësira dhe çdo gjë që e rrethon këtë ambient është në harmoni me tokën dhe qiellin, nisi një tregim i jashtëzakonshëm i performancës “Gjuetaret e Artemidës”. Ky proces krijues filloi nga një vizitë në natyrën e qetë, që ishte shërim për trupin dhe shpirtin, e që e frymëzoi regjisoren Zana Hoxha, të krijojë një vepër që është në përputhje me natyrën si perëndeshë shëruese, burim i jetës dhe energji e pashtershme. “Gjuetaret e Artemidës” dalëngadalë u formësua duke personifikuar shpirtin e një gruaje të pavarur duke bërë rit-

ualet pagane dhe duke dhënë dashuri e solidaritet në harmoni me natyrën. Koreografia, muzika, kostumet dhe performanca e aktoreve, ishin rezultat i emocioneve dhe ndjenjave që zgjoi kjo simbiozë e natyrës me gruan dhe artin, e cila u përshtat plotësisht me vendin, atmosferën dhe ngjarjen e Etno Fest-it. Kjo shfaqje ka qenë nën regjinë e Zana Hoxha, me muzikë nga Arbër Salihu dhe koreografi nga Robert Nuha si dhe aktoret: Aurita Agushi, Semira Latifi, Donikë Ahmeti, Daniela Markaj, Qëndresa Kajtazi, Hajat Toçilla, Fitore Jashari. Prezent në këtë performancë ishin rreth 100 persona.

Gjithashtu në këtë ditë është prezantuar edhe **Ekspozita e Pikturave “Holocaust”**. Kjo ekspozitë nga Mirjeta Qehaja paraqet problemet me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë, personat me aftësi të kufizuara e grupe të tjera shoqërore, që për Mirjetën paraqesin një holokaust modern, të cilëve nuk iu rrezikohet jeta drejtpërdrejtë por në mënyrë latente. Prezent në hapjen e ekspozitës kanë qenë rreth 150 persona.



FESTIVALI FEMART – EDICIONI I 8-TË, 15-20 TETOR, 2020 NË PRISHTINË



Dita e parë e Festivalit FemArt filloi me 15 Tetor, 2020, hapja e festivalit edhe këtë vit u bë nga një ekspozitë, kësaj radhe nën kurimin e Arta Aganit, me titull **“Akti i Mbrëmjes”**. Në këtë ekspozitë artistet/ët që morën pjesë ishin: Adea Pula, Adriana Sedaj, Ardita Rafuna, Artan Hajrullahu, Besfort Syla, Fjolla Ferati, Jakup Ferri, Lumjete Havolli, Vlora Hajrullahu dhe Zake Prelvukaj. Koncepti i ekspozitës: Jetojmë në një kohë kur pamja e jashtme është gjithçka, mediat sociale janë njësi matëse e suksesit, vlerat janë të kthyera mbrapsht ndërsa standardet e imponuara të bukurisë janë praktikisht të paarrtshme. Si rezultat, njerëzit i kushtojnë kohën e vlefshme vlerave sipërfaqësore ndërsa efekti që arrihet është negativ dhe dëmton marrëdhëniet ndër njerëzore, e në disa raste çon edhe te gjendja e rëndë psikologjike. Ekspozita “Akti i Mbrëmjes” hulumton paraqitjen, keqpërdorimin dhe keqinterpretimin e trupit në mediat sociale dhe në art, e sidomos artin në internet, derisa ky interpretim nuk është gjithmonë i drejtpërdrejtë. Këtu vihet në pyetje relacioni mes artistit si individ dhe censurave të shoqërisë patriarkale, ndërsa diskutohet fenomeni i standardeve të reja të bukurisë, simboleve seksuale të statusit si dhe pasojat e vetë-objektifikimit në mediat e shekullit tonë. Kjo ngjarje është zhvilluar në hapësirën e Galerisë së Fakultetit të Arteve në Prishtinë, prezent në këtë ekspozitë ishin më shumë se 200 njerëz.



Në ditën e parë ne vazhduam me Koncert nga Ansambli “Zanat” me solistet: Adelina Thaqi-Meta, Elida Kryeziu-Hoti, Diellza Sylejmani, Arstina Kelmendi , Albana Piperku dhe pianist: Edon Ramadani. Koncerti i zhvilluar nga ky ansambël ka bërë shumë që të ftuarit/ftuarat të ndjehen jashtëzakonisht mirë nën melodinë e këngëve që “Zanat” kanë kënduar atë ditë, duke ringjallur shumë pjesë të buku-

ra e të vjetra të muzikës e traditës shqiptare, kryevepra të harruara e përplasma mënjanë nga dallgët e furishme të kësaj e të jo vlerave – po aq fuqishëm duan, që të sjellin në jetë - edhe shumë këngë e vepra krejtësisht të reja, që burojnë nga muzat e tyre...! Ansambli është formuar në fund të vitit 2017-të, nga pesë profesoresha të muzikës dhe të solo këndimit, njëkohësisht edhe anëtare të Korit të “Filarmonisë së Kosovës”.



Emri që përzgjedhën artistet prishtinase për ansamblin e tyre, “Zanat”, që në anglisht i bie «the voices», por që në shqip ngërthen e përmban edhe disa kuptime krejtësisht tjera që vijnë nga mitologjia - shpalon pa mëdyshje, shumësinë e misionëve dhe caqeve që kanë shënjuar si ansambël, por gjithsesi, edhe si personalitete. Themelueset e Ansambilit “Zanat”, duan të shpalojnë gjithandej, këngët e vjetra dhe autoktone shqipe, ato të gjitha varieteteve dhe trevave - qofshin vepra e këngë të Prishtinës, Prizrenit apo Gjakovës - apo qofshin “Iso-polifonitë” e trevave të Jugut të Shqipërisë - që njihen



edhe zyrtarisht nga UNESCO, si “Kryevepra unike, të trashëgimisë gojore të njerëzimit”! Koncerti është mbajtur në Teatrin Oda me rreth 70 persona prezent. Koncerti gjithashtu është shfaqur edhe me livestream në rrjetet tona sociale ku ka pasur 6300 ndjekës.



Dita e dytë e Festivalit Femart ka filluar me datë 16 Tetor, 2020 me **konferencën dhe publikimin e raportit “Drejt solidaritetit dhe bashkëpunimit”, autore Gresa Rrahmani**. Ky hulumtim është fokusuar në tri fusha: shoqërinë civile, media dhe institucionet kulturore, dhe ka synuar të analizojë se çfarë ndikimi ka rritja e numrit të grave në pozita vendimarrëse. Në rastet kur gratë janë udhëheqëse të institucioneve a ka ndryshime në politikat e këtyre institucioneve? Nëse po, si manifestohen këto ndryshime. A ka përmirësime në jetën dhe përfaqësimin më të lartë të grave tjera si dhe grupeve të marginalizuara, minoriteteve dhe grave e burrave me aftësi të kufizuara? A ka ndryshime në miratimin e politikave më të barabarta dhe përfitime të tjera për komunitetin?

Paneli ka filluar me fjalë hyrëse nga: Nasrin Pourghazian - Zëvendëse e Shefit të Misionit, Shefe e Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Vlora Dumoshi – Ministre e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Më pas kjo konferencë ka vazhduar me dy panele:

Paneli 1: “Përfaqësimi i grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës” – Perspektiva ndërkombëtare dhe vendore. Panelistet: Tenzin Dolker - Aktiviste dhe Feministe, Blerta Basholli, - Drejtoreshë e drejtorisë së kulturës në komunën e Prishtinës, Nermin Mahmuti-Drejtoreshë Ekzekutive, Fondi për Zhvillim Komunitar dhe Lian Bell – Artiste nga Irlanda.

Paneli 2: “Përfaqësimi i grave në shoqëri civile, media dhe institucione të kulturës” në

Kosovë. Panelistet: Tijana Simić LaValley - Drejtore e programit në OJQ “Të drejtat e grave” dhe aktiviste për të drejtat e grave, Saranda Bogujevci – Anëtare e Parlamentit të Republikës së Kosovës, Valdete Idrizi - Anëtare e Parlamentit të Republikës së Kosovës, Ivane Petronić Vanovac - Radio KM, Luljeta Demolli – Drejtoreshë Ekzekutive – Qendra Kosovare për Studime Gjinore. Të gjitha panelet janë moderuar nga Donika Emini – Drejtoreshë Ekzekutive e platformës Civikos. Konferenca është mbajtur në teatrin Oda me rreth 30 persona prezent. Konferenca ka qenë edhe livestream ku është ndjekur nga 2200 persona.

Gazeta online Insajderi ka përcjellur konferencën dhe citon “Në lidhje me këtë, ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e cila edhe bëri hapjen e këtij publikimi, tregoi se e ka lexuar me vëmendje këtë raport dhe e ka shikuar me kujdes analizën që është dhënë. Ajo tha se ky raport është i mirëseardhur dhe pritet të merret parasysh në aspektin e përmirësimit, teksa tregoi përvojën e saj dhe punën disa vjeçare në shkollimin e grave. Nëse e shohim historikisht, roli i gruas në vend, lë për të dëshiruar, por këtë duhet ta qesim në dy rrafsh, rrafshi i parë është sa janë gratë të gatshme të marrin vende udhëheqëse. E pash që në raport ka dalë që në ligjet e institucioneve tona nuk shkruhet që edhe gruaja duhet të marrë pjesë, mendoj që është ligji për barazi gjinore dhe kushtetuta dhe besoj që në ligje të mos ceket as mashkulli as femra, pra të jemi të barabartë”, ka theksuar Dumoshi”. Ndërsa autorja e raportit Gresa Rrahmani citon “Qëllimi i hulumtimit fillimisht ka qenë kur jam takuar me Zanën kemi dashtë me e pa kur gratë arrijnë në pozita të pushtetit dhe vendim-marrëse, atëherë çfarë ndikimi ka kjo për shoqërinë, a ndikon kjo në përmirësimin e grave tjera, personave me aftësi të kufizuara, komunitetit LGBTI, e kështu me radhë. Rrjedhimisht me këtë jemi nis dhe gjatë hulumtimit e kemi parë që situata nuk është ashtu siç kemi menduar, dhe e kemi parë që gratë janë shumë pak në pozita drejtuese”, theksoi ajo. Ajo tregoi se për arsye se fusha e kulturës është shumë e gjerë, atëherë janë fokusuar vetëm në institucionet brenda Ministrisë së Kulturës, që janë: Teatri Kombëtar i Kosovës, Galera Kombëtare e Kosovës, Galeria Qafa, Ansambli Shota, Filarmonia e Kosovës, Qendra Kine-matografike e Kosovës”.

Pas Konferencës është prezantuar për herë të parë në rrjetet tona sociale episodi i parë i serisë: **Femart Podcast: Feminism 101, me titullin “Feminizëm, Meninizëm a Humanizëm”**. Në këtë podcast është biseduar se çka është feminizmi si teori dhe praktikë? Si gërshetohen identitetet socio-politike për të sjellë shtypje të shumëfishtë? Prej kujt dhe për kë është feminizmi? Këto pyetje dhe shumë të tjera rreth kategorive gjinore dhe përpjekjeve për drejtësi. Autore dhe moderatore është Uresa Ahmeti, ndërsa folëset: Vjollca Krasniqi dhe Mirishahe Sylja. Është ndjekur nga 350 persona live në rrjetet sociale ndërsa në Teatrin Oda u ndoq dhe u dëgjua nga 30 veta sa ishin prezent.



Dita e dytë e festivalit Femart ka përfunduar me performancën **“A je çikë, a djalë!”** premierë në Femart nën produksionin e Artpolis.

Kjo performancë ka përfshirë muzikë, lëvizje, tregime dashurie, intriga, urrejtje dhe dhimbje që u janë shkaktuar komunitetit LGBTI+ për shkak të mospranimin të tyre si njerëz me preferenca të ndryshme seksuale dhe shprehje të ndryshme të identiteteve të tyre gjinore. Skena është hapur me një djalë të vogël që dëshironte të dukej si vajzë. Familja e detyronte të shkonte të ushtrojë sportin e boksit në mënyrë që të burrërohej. Por dëshira e tij ishte të veshë fustanet e mamit që ajo i veshte çdo ditë, e të vë grimin e egër e të bukur para pasqyrës. Mos shprehja e dëshirave tona deformon identitetin tonë, perceptimin e vetvetes, e rrjedhimisht krijon përbindësia të brendshme e të rrezikshme. Të jesh ndryshe nuk është mëkat, përkundrazi, i shton nuancë njerëzimit në shumë rrafsh, ka potencuar Arlinda Morina, regjisore e kësaj performancë me Aktorët/e : Hajat Toçilla, Diva, Agatha Bones dhe Vjeshta. Kjo shfaqje është mbajtur në teatrin Oda me rreth 70 persona prezent.

Dita e tretë e festivalit FemArt ka vazhduar me datë 17 Tetor, 2020, me **punëtorinë “Mësimet nga Zed”** e udhëhequr nga **Zoe Gudović**. Kjo punëtori ka pasur për qëllim që të shpërbëjë identitetin përmes teknikave të veshjes dhe zënies së vendit. Këtu është përf-

shirë një edukim i shkurtë mbi ndërhyrjet kreative dhe artistike të performueseve drag king, të frymëzuar nga Diana Torri dhe puna e saj, si dhe një punëtori më të gjatë praktike ku pjesëmarrësit/et kanë provuar menjëherë veshjet për personazhet e tyre drag. Shumë prej nesh shpesh përfitojnë se si do të dukeshim nëse ia lejojmë vetes të sillemi siç sillen burrat në mjedisin tonë privat ose publik. A e kemi «atë» në gjak? Dhe çka nënkuptojmë me «atë»? A e duam me të vërtetë «atë» në jetën tonë? Përmes kësaj punëtorie, bashkërisht u “zbërthyen” identitetet e gjinisë mashkullore që i kemi në vete dhe në shoqëri, por duke u argëtuar shumë. Kjo punëtori është mbajtur në Galerinë e Fakultetit të Arteve me 10 persona.



Po në këtë ditë ne kemi shfaqur edhe 2 podkasta në rrjetet tona sociale dhe gjithashtu si audio në teatrin Oda.

Femart Podcast: Feminism 101: Podkasti “Çka ke ti, asi a ksi? Homo, hetero dhe gjithçka në mes e jashtë tyre”, ka pasur për qëllim të na informojë se: seksi, gjinia dhe seksualiteti janë një spektër. Ato merren dhe rregullohen si kategori binare dhe antagonistë. Cilat janë

kutitë ku personat LGBTI+ po futen dhe cilat janë sfidat dhe pasojat sociale e institucionale si pasojë e mospranimit për të ekzistuar në ato limite?

Podkasti është udhëhequr nga Uresa Ahmeti si dhe me folës/e: Arlinda Morina dhe Lend Mustafa. Ky podkast është ndjekur nga 220 persona në rrjetet tona sociale por edhe nga 20 persona që ishin prezent në Teatrin ODA, ku u lëshua si audio.

Femart Podcast: Feminism 101: Podkasti tjetër: “Penisi, Vagina dhe krejt tjerat: Mësimet e biologjisë që s’u dhanë kurrë”. Në këtë podkast janë trajtuar tabutë shoqërore rreth seksit dhe seksualitetit njerëzor që janë të mëdha. Edhe institucionet publike, si shkollat, e riprodhojnë heshtimin e këtyre temave esenciale për njohjen e trupit njerëzor. Për më shumë rreth trupit të njeriut dhe identitetit seksual prej perspektivës mjekësore kanë fole prof. Hajrullah Fejza dhe Blert Morina, ndërsa biseda u udhëheq nga Uresa Ahmeti. Ky podkast është ndjekur nga 404 persona në rrjetet tona sociale ndërsa në Teatrin ODA nga 20 persona që ishin prezent.

Pas podkast në Galerinë e Fakultetit të Arteve është prezantuar **Ekspozita “Në përqafim me ZZ”** E tërë ekspozita është përbërë nga dy seri të fotografive të përqafimeve, videove dhe pamjeve të gatshme dhe përqendrohet në performativitetin që është i pranishëm në praktikën si aktiviste dhe artiste të Zoe Gudović-it. Dualiteti drithëruar është mishëruar në Zoe-n në njërën anë, si zëdhënëse e mirënjohur dhe luftëtare për të drejtat e grave dhe lesbikeve dhe Zed Zeldich Zed-it në anën tjetër, si drag king i parë në rajon. Ekspozita gjithashtu përpiket të vë në pikëpyetje padukshmërinë e historisë vendore të komunitetit homoseksual përmes vendosjes së narratives së re si pasojë e përvojës personale dhe kolektive. Zoe Gudović përmes kësaj ekspozite dëshiron të vë në pikëpyetje gamën e performativitetit personal si thelb të jetës dhe punës së saj private, aktiviste-politike dhe artistike. Kurator i kësaj ekspozitë ishte: Vladimir Bjeličić. Kjo ngjarje është ndjekur nga 20 persona.

Dita e tretë e festivalit Femart është mbyllur me shfaqjen teatrale **“Tri Motrat dhe Natasha P.”** nga **Maqedonia e Veriut, nën regjinë e Natasha Poplavska** si dhe me aktorët/et: Ana Stojanovska, Labinot Raci, Flamur Ahmeti dhe Mjellma Ibrahim.

Sinopsisi i shfaqjes: “Tri motrat” e Chekhov me fokus në personazhin e Natasha Prozorova, e cila shfaqet e para në listen e personazheve. Natasha është grua e Andrej Prozorov, vëllai i tri motrave: Olga, Masha dhe Irina. Duke pasur parasysh që drama titullohet “Tri motrat”, ne parashtrijmë pyetje të thjeshta, si: pse Natasha është në listë të personazheve para Olga, Masha dhe Irina? Nëse ajo është personazhi i parë grua, pse nuk po shfaqet e para në dramë? E kujt është “drama”? “Drama” e Andrej, e Natashas apo kjo është “drama” e Tri motrave? Çfarë përgjigjesh do të marrim?..... Shfaqja është mbajtur në teatrin Oda me rreth 30 persona prezent.



Dita e katërt e festivalit Femart ka filluar me datë 18 Tetor, 2020, dita ka filluar me **Femart Podcast: Feminism 101 me Podkastin “A bon me t’prek?”**. Në këtë episod u fol për dhunën dhe sa i përhapur është ky fenomen, çfarë është bërë për t’a luftuar dhe çfarë mbetet të bëhet tutje, ka qenë thelbi dhe fokusi i bashkëbisedimit ndërmjet dy aktivisteve dhe përfaqësueseve të grupeve të shoqërisë civile. Podkast është udhëhequr nga Uresa Ahmeti ndërsa folëset ishin: Luljeta Demolli dhe Adelina Tërshani. Podkast është shfaqur në rrjetet tona sociale dhe me audio në teatrin Oda me rreth 124 ndjekës dhe prezent ne Oda me rreth 20 persona.

Po në këtë ditë në sheshin Skënderbe, në ambient të hapur është mbajtur **Performanca “Silver Boom”** duke prezantuar Festivalin Hapu në Femart nën koreografinë e Anna Anderegg nga Zvicra.



Kjo performancë ka qenë një intervenim artistik i grave të moshuara në hapësirën publike. Kjo punë unike vë në pikëpyetje marrëdhënien mes hapësirës, qytetit, gjinisë dhe moshës. Kjo performancë ka pasur për interes zbulimin e vetëdijes kolektive përmes kremtimit të vallëzimit të grave me përvojë në peizazhin tonë urban. Performanca “Silver Boom” bëri bashkë gjashtëmbëdhjetë gra në moshë, zbërtheu

këtë aspekt duke u përqendruar te rritja e vetëdijesimit kolektiv. Ishte si një intervenim artistik që mund të cilësohet edhe si dialog midis trupit njerëzor dhe hapësirës publike përreth. Koreografa Anna Anderegg dhe ekipi i saj kanë punuar në rezidencë artistike 2 javore me një grup të qytetareve të Kosovës në Teatrin ODA.

Kjo performance është organizuar në bashkëpunim me Festivalin Femart dhe Teatrit Oda. Performanca është ndjekur nga 50 persona.

Pas kësaj performancë në teatrin Oda është mbajtur një diskutim së bashku me të gjitha pjesëmarrëset dhe me koreografen Anna ku është diskutuar i gjithë procesi i punës dhe



se si është zhvilluar e gjithë performanca duke eksploruar emocionet dhe ndjenjat e tyre karshi gjithë kësaj kohe sa kanë punuar së bashku. Diskutimi është mbajtur në teatrin Oda dhe është përcjellë nga 30 persona. Kjo performancë është prezantuar edhe në livestream në rrjetet tona sociale me 286 persona që e kanë ndjekur live këtë performancë.

Kimete Zeqa (71vjeçe), pjesëmarrëse e kësaj performance, për gazetën Koha Net ka cituar: “Ishte sikur po hiqja gjithë barrën nga vetja dhe po çlirohesha”. Ka shtuar se njerëzit janë të tillë që mund të pyesin se çfarë po bën kjo grua në këtë moshë. “Por, kjo nuk është asgjë e pamoralshme”, ka shtuar ajo duke potencuar se thjesht e kanë shfrytëzuar hapësirën që u takon. “Aktivitetet të cilat i kemi bërë, lëvizjet, ishin shumë interesante për shkak të hapësirës që e kemi shfrytëzuar. Më është dukur vetja shumë e liruar, kam thënë shqyr që jam në vendim tim: Lëvizi lirshëm, marr pozitën që dua, ulem kur dua dhe ndalem kur të dua”, ka thënë ajo.



Në këtë ditë është dhënë **Premiera e Shfaqjes “ Ti, jam unë”** produksion i **Arptolis**. Kjo shfaqje ka vënë në pah një mësuese, profesion ideal në shoqërinë kosovare. Aludon në atë se njerëzit e shohin mësuesen si një person të përkryer. Por, mësuesja e Kallabës, të cilën e luan aktorja Tringë Hasani, nuk është aspak e tillë. Është e divorcuar, ka ndërruar disa burra, ka një jetë të shthurur e ndjenja, që nuk konsiderohen tradicionale. Përkrah saj është një gazetare, e cila në një mënyrë është një marionetë e mësueses dhe pastrueses.

Kjo shfaqje është dhënë ne teatrin kombëtar të Kosovës nën regjinë e Natyra Kallaba dhe me aktoret: Tringa Hasani, Florieta Bajraktari, Fitore Jashari dhe është përcjellë nga 80 persona.

Regjisorja Kallaba për Koha Net ka potencuar: “Kam dashur që të them se pa marrë parasysh se çka jemi, ne i kemi ndjenjat e njëjta, një trup, një gjak dhe mundemi njëri-tjetrit t’a gjejmë tek njëri-tjetri, por varet prej kohës”.



Dita e katërt e festivalit Femart ka përfunduar edhe me një premierë tjetër me **Produksion të Artpolis: Forum Dans Teatër “Çfarë duan burrat?”**. Nëpërmjet kësaj shfaqje është diskutuar se çfarë duan burrat, dashuri, besim, përkujdesje, ngrohtësi, liri, barazi... pra, gratë duan atë që duan edhe burrat!

A kemi harruar të pyesim se çfarë duan gratë dhe burrat modern, apo pavarësisht kohës nevojat mbesin të njëjta?

Ne nuk i kemi gjetur përgjigjet ende!... mirëpo jemi të hapur dhe të interesuar që të zhvillojmë një dialog me gratë në publik, duke e vënë kështu në shërbim artin tonë dhe duke sfiduar vlerat dhe besimet e ndryshme.

Kjo performancë është zhvilluar nën regjinë dhe koreografinë e Robert Nuha dhe Edlir Gashi ku gjithashtu kanë qenë edhe performues të kësaj performance. Ky aktivitet është mbajtur në teatrin Oda me 70 persona prezent. Kjo shfaqje ka shkuar edhe live në rrjetet tona sociale ku e kanë ndjekur 247 persona.



Dita e pestë e festivalit Femart ka filluar me 19 Tetor, 2020 me **Punëtorinë “Covid-ia Dell’Arte**, kjo punëtori si ide ka ardhur nga situata pandemike që është krijuar në mbarë botën por duke e lidhur pandeminë me teatrin, autorja e kësaj punëtorie Natasha Poplavska citon “Meqenëse maskat janë rekuizitë teatrale, po mendoj që sërish ka ardhur koha historike në teatër. Detyra jonë është të riprodhojmë maska

dhe t’i përshtatim ato për teatrin bashkëkohor. Në këtë kontekst, ne do të mundohemi të ribjëm maskat dhe personazhet për *comedia dell’arte* në maska dhe personazhe për *covidia dell’arte*.” Punëtorja është realizuar në teatrin Oda ku kanë qenë prezent rreth 10 persona.

Pas punëtorisë ne kemi vazhduar me shfaqjen e **Femart Podcast: Feminism 101, në rrjetet tona sociale me titull “Qysh me e dashtë vetën që me e dashtë edhe tjetrin”**. Këtu është diskutuar mbi faktorët e jashtëm që sjellin trauma dhe përkeqësim të gjendjeve emocionale dhe mendore, si dhe çfarë mund të bëjmë për t’i kaluar ato? Çka do të thotë të duash veten, dhe cilat janë mënyrat për të bërë progres në këtë rrugëtim? Këto dhe shumë mesazhe pozitive vijnë nga një perspektivë psikologjike. Edhe ky podcast ka pasur autore: Uresa Ahmeti me folëse Elvira Haxhiaga, i cili është ndjekur nga 103 persona në rrjetet tona sociale dhe 20 persona e kanë dëgjuar në teatrin Oda.

Në këtë ditë kemi vazhduar me aktivitetin e radhës “Nata e filmit” me shfaqjen e filmave të regjisorëve tona Kosovare në Kino Armata. Në këtë natë janë shfaqur edhe disa premiera të filmave në Kosovë. **Regjisorët që prezantuan filmat e tyre ishin: Dea Gjinovci, More Raça, Blerta Zeqiri, Zana Hoxha, Rita Krasniqi, Hana Bucaliu, Albana Nila, Vesa Potera, Lorena Sopi, Dita Shaqiri.**



Sinopsistat e filmit do të renditen të gjitha më poshtë për të kuptuar më shumë rreth natyrës së filmave që janë prezantuar në këtë mbrëmje.

Dea Gjinovci me filmin “Wake up on mars” - Një djalë 10-vjeçar rom, refugjat nga Kosova, që jeton në Suedi përpiqet të pajtohet me sindromën misterioze të dorëheqjes (tërheqjes) që ka vënë dy motrat e tij në koma. Familja e lidhur ngushtë po përpiqet të rindërtojë një jetë normale larg Kosovës së tyre, ku ata ishin viktimë të persekutimit. Ndërsa e gjithë e ardhmja e tyre qëndron në ekuilibrin e një kërkese në pritje të azilit, djali i vogël ëndërron të ndërtojë një anije kozmike për t'i lënë të gjitha pas.

Zana Hoxha me filmin “ Gjuetaret e Artemedës” - Inspiruar nga natyra dhe bukuritë e saja të fshatit Kukaj, aty ku hapësira dhe çdo gjë që e rrethon këtë ambient është në harmoni me tokën dhe qiellin, nisi një tregim i jashtëzakonshëm i performancës “Gjuetaret e Artemidës”. Ky proces krijues filloi nga një vizitë në natyrën e qetë, që ishte shërim për trupin dhe shpirtin, e që e frymëzoi regjisorën Zana Hoxha, të krijojë një vepër që është në përputhje me natyrën si perëndeshë shëruese, burim i jetës dhe energji e pashtershme. “Gjuetaret e Artemidës” dalëngadalë u formësua duke personifikuar shpirtin e një gruaje të pavarur duke bërë ritualet pagane dhe duke dhënë dashuri e solidaritet në harmoni me natyrën.

Koreografia, muzika, kostumet dhe performanca e aktoreve, janë rezultat i emocioneve dhe ndjenjave që zgjoi kjo simbiozë e natyrës me gruan, dhe artin, e cila u përshtat plotësisht me vendin, atmosferën dhe ngjarjen e Etno Fest-it.



More Raça me filmin “Ajo” - Zana merr guximin për të shpëtuar vetën dhe nënën e saj.

Blerta Zeqiri me filmin “Lajmi” - Lajmi është një film dramë që trajton çështjet e komunitetit LGBTQ në shoqërinë kosovare.

Rita Krasniqi me filmin “Adelina” - Adelina, një Drag Queen e Kosovës përballlet me ditën e saj më të errët ndërsa përpiqet të përfshijë motrat e tjera të saj në klubin që ajo performon fshehurazi. Shoqëria nuk është shumë e sjellshme pasi të zbulohet Adelina - këto ngjarje çojnë në denoncim pa ngjyrë dhe pa dashuri.

Gazeta Scanner për filmin “Adelina” potencon: “Më 19 tetor, Festivali i Filmit FemArt mbajti premierën kombëtare të filmit të ri të Rita Krasniqit “Adelina”. Një film i shkurtër i financuar nga Qendra e Kinematografisë së Kosovës. Publiku kishte një përgjigje pozitive ndaj filmit pasi ai solli me vëmendje shoqërinë kosovare, realitetin e trishtuar dhe të ashpër të komunitetit LGBTQI + në Kosovë. Një film i cili qëndron besnik në luftën kundër padrejtësisë shoqërore dhe luftës së vazhdueshme për të drejtat e njeriut. Rita ka folur hapur se si ky film është një betejë për të luftuar homofobinë në një shoqëri që shpesh mohon ndryshimin. Si një grua e re vetë, në një shoqëri patriarkale, ajo ka qenë gjithmonë e shtyrë të luftojë për barazi”.

Hana Bucaliu me filmin “Mollëkuqja” - Për të fituar një apartament në kryeqytet, Shabani (40) së bashku me gruan dhe fëmijët e tij, janë të detyruar të përgatiten për ardhjen e një programi televiziv që do të tregojë gjendjen e tyre të vështirë financiare në media.

Albana Nila me filmin “Horoskopi, Grimi dhe dhembet që mungojnë” - Rutina e një gruaje 40 vjeçare dhe sfidat që e përcjellin atë në një episodë të manisë.

Vesa Potera me filmin “Lojë” - Disa djem të vegjël ndalin lojën e futbollit në gjysmë të shohin pa dashje një grua në një shtëpi teksa ajo bën vetëvrasje.

Lorena Sopi me filmin “Schauerfilm” - Në një nga Shkollat e Filmit, gjatë klasës së historisë, disa studentë janë zhdukur. Profesori dërgoi kolegët për të ftuar studentët. Studentët që janë dërguar për ti ftuar ata nuk kthehen. Ata janë të humbur dhe të zhdukur në një mënyrë misterioze mes labirinteve dhe klasave të shkollës.



Dita Shaqiri me filmin “Pulla e zezë, fustan nusërie dhe dhëndri që mungon” - Nëna dhe Monika po bëhen gati për dasmën e Monikës në rrobaqepësinë e Lumes e cila jep me qera dhe përgatit fustane për ata njerëz në nevojë. Derisa të tria mes vete konsultohen për fustanin dhe dukjen e Monikës, familjarët e Monikës dhe të dhëndrit vijnë ne rrobaqepësi. Secili prej tyre fillon të intervenojë në fustan dhe në dukjen e saj. Pas shumë intervenimesh, Monika sheh që e tërë situata dhe fustani është qesharake dhe vendos të dal nga dritarja e rrobaqepësisë.

Pas shfaqjes së filmave është mbajtur edhe një panel diskutimi ndërmjet regjisoreve duke nderuar regjisoren e ndjerë Arzana Kraja dhe gjithashtu duke diskutuar për mundësitë e vogla që këto regjisore kanë për realizimin e filmave të tyre. Ky diskutim është mbajtur nën moderimin e Arbër Selmanit në Kino Armata dhe është ndjekur nga 40 persona. Kjo ngjarje është mbajtur edhe live me një ndjekje nga 610 persona përmes rrjeteve tona sociale.



Dita e pestë e festivalit Femart ka përfunduar me **Performancën Dansi “Lidhmë mua”**. Në këtë shfaqje janë shprehur lëvizjet dhe roli i gruas në shoqëri si dhe trajtimi që i bëhet atyre. Ngarkesa psikologjike që i krijohet gruas për të arritur të drejtën në shoqëri bën që kjo shfaqje të ketë ndikim jo vetëm tek gratë por në të gjithë shoqërinë. Me anë të kësaj shfaqje është synuar që t'i vetëdijësojmë publikun përkatësisht shoqërinë për vlerat dhe rëndësinë e secilit njeri, si dhe për ndikimin që kanë veprat e tyre në shoqërinë tonë. Shfaqja është mbajtur në teatrin Oda nën koreografinë e Luljeta Brahës dhe është përcjellë nga 30 persona. Ndërsa live në rrjetet sociale me ndjekje nga 280 persona.

Dita e gjashtë dhe e fundit e festivalit Femart me datë 20 Tetor, 2020, dita ka filluar me **Femart Podcast: Feminism 101 e fundit “Me një Lule s’qel pranvera, me këmbë e duar, bashkë e përpara”**. Në këtë podcast është biseduar më shumë rreth aktivizmit feminist përmes metodave të ndryshme të organizimit formal e joformal, ndikimin dhe ndryshimet sociale që vijnë si rrjedhojë. Ky podcast është udhëhequr nga Uresa Ahmeti me folëse Luljeta Aliu dhe Liza Gashi, është shfaqur në rrjetet tona sociale dhe si audio në teatrin Oda me 107 ndjekës në Facebook dhe në teatrin Oda me prezent 20 persona.



Pas podcast në kemi vazhduar me **Publikim e broshurës dhe panel diskutimi “Artivizmi – Arti dhe Solidariteti në kohë pandemi”**.

Pandemia bllokoi aktivitet kulturore në rrafshin global mirëpo, frymëzimet individuale veçse u rritën më shumë, duke ia dëshmuar botës edhe njëherë fuqinë dhe nevojën për art. Një adresë e bashkimit të këtyre krijimeve u bë kampi i artisteve dhe aktivisteve i organizuar nga organizata Artpolis. Qëndrimi i përbashkët në Kukaj në datat 26-29 qershor duke mbajtur sesione pune grupore për ushtrime të lëvizjeve skenike, shkrim kreativ, meditim e çlirim shpirtëror, i bëri aktivistet dhe artistet të ndjehen tejet mirë dhe të mbetet ky organizim përherë në mendjet e tyre.



Ato folën, shkruan, u paraqitën me gjuhën e artit, duke e sfiduar veten në çdo fushë, e duke u vete mjaftuar nga ndjesia estetike që ndjenin. Të ndara në 4 grupe pune, krijuan një lidhje inspiruese e kreative mes vete, duke sjellë si përfundim 4 performanca artistike, 2 prej të cilave u dhanë premierë në FemArt si dhe shkrimet e tyre që adresonin çështje sociale dhe qëllimet e tyre. Fjalët e vargjet të cilat pasqyruan shpirtrat e tyre, u kthyen në një broshurë, e cila përmban një laramani të pikëpamjeve dhe u promovua përpara publikut në panelin e diskutimit në ditën mbyllëse të Festivalit FemArt. Autorët e shkrimit të broshurës ishin: Arta Lahu, Arta Muçaj, Aurita Agushi, Rajmonda Ahmetaj, Fitore Jashari, Linda Hyseni Molikë Maxhuni, Natyrë Kallaba, Qëndresa Kajtazi, Sheqerie Buqaj, Shqipe Gashi, Teuta Gashi, Uresa Ahmeti, Valdete Idrizi ndërsa panelistët e këtij paneli: Eliza Hoxha, Valdete Idrizi, Zana Hoxha, Rajmonda Ahmetaj, Natyrë Kallaba dhe Arlinda Morina, nën moderimin e Shpëtim Selmanit. Ky panel është mbajtur në Teatrin Oda me 15 persona prezent si dhe livestream në rrjetet tona sociale me 1100 ndjekës. Gazeta Kultplus shkruan “Zana Hoxha, si themeluese e FemArt theksoi se iniciativa për këtë kamp kishte nisur me qëllim të arritjes së paqes e harmonisë, solidaritetit e inspirimit.” “Iniciativa për kampin e artisteve dhe aktivisteve ka ardhur si nevojë në vitet e kaluara që të bëhemi bashkë, ku qëllimi ka qenë të gjejmë forma të krijuarit pa pasur një agjendë strikte dhe rezultatet të vijnë natyrshëm”, u shpreh Hoxha. Njëra ndër pjesëmarrëset në kamp ka qenë edhe aktivistja politike, Valdete Idrizi e cila përgjatë diskutimit tregoi se aty kishte shkruar e aktruar për herë të parë. “Siguria që e ka dhënë kampi, ka krijuar hapësirën për t’u ndjerë shumë rahat dhe të shpalos e reflekttoj për atë çfarë ndjej”, u shpreh Idrizi. Si politikane e cila ka rol në vendimmarrje, ajo premtoi publikisht se do të bëjë maksimumin e saj në mënyrë që kampi të jetojë për shumë edicione dhe shumë gra të tjera të frymëzohen nga një atmosferë kolektive artistike. Për të ndarë përvojën e saj, prezente ishte edhe këngëtarja, tanimë politikanja Eliza Hoxha. Rugëtimin me shkrim ajo e ka nisur pas rikthimit nga studimet në Belgjikë, të cilën e ka nxjerrë mos dokumentimi i gjërave në Kosovë. Kështu ajo tregon se ia kishte lënë vetes synim që të shkruaj për çështjet sociale në kontekst urban, jetën kulturore por edhe ndjenjat personale, dikur për të filluar edhe me tekstet e këngëve të saj”.



Pas këtij aktiviteti ne kemi vazhduar me **Performancën “T’u e marrë “Fuqinë” n ‘pyetje”**, premierë dhe produksion i Artpolis nga Uresa Ahmeti. Në këtë shfaqje është paraqitur një grua e tensionuar e cila mundohet të mbetet gjallë nga puna e saj shumë dimensionale; si amvise, punonjëse e një zyre, e edhe si grua me elegancë të kushtëzuar nga patriarkati kapitalist. Shpirti i saj shndërrohet në një robot të gjallë. Nga lëvizjet e saj të shpejta ne kuptojmë epokën e frustrimit teknologjik e fanatik. Kjo performancë është mbajtur në teatrin Oda dhe është përcjellur nga 30 persona.



Nata e fundit e festivalit Femart ka prezan-
tuar edhe **Shfaqjen Muzikore “Zgjimi i
Pranverës”** Një bashkëpunim në mes të
Teatrit Kombëtar të Kosovës me Artpo-
lis – Qendra për Art dhe Komunitet sjellin
shfaqjen muzikore “Zgjimi i Pranverës” në
Prishtinë nga autori Frank Wedekind me
regji dhe adaptim të regjisores Zana Hoxha.
Për regjisoren e shfaqjes Zana Hoxha kryeve-

pra e autorit Frank Wedekind “Zgjimi i Pranverës” ishte një thirrje artistike, dëshirë e nevojë
për ta sjellë atë në Kosovë, tutje duke e adaptuar atë në Kosovën e viteve të 90ta. Nevoja
e të rinjve për të kuptuar dhe për tu kuptuar ka qenë dhe vazhdon të jetë sfidë, sidomos
historia që i ka përcjellë të rinjtë tanë në vitet e 90ta, kohë protestash e rezistence, kohë kur
liria kolektive dhe personale ishte e kufizuar nga regjimi politik i Millosheviqit dhe patriarkati
i rrënjëzuar në Kosovë, përderisa solidariteti mbante gjallë frymën e rezistencës kolektive.
Rinia dhe nevojat e natyrshme të rinisë nuk kanë qenë prioritet andaj edhe informacionet për



seksualitetin, ndjenjat, dashuritë e përvojat e tyre kanë qenë të limituara dhe të neglizhuar nga familja, shkolla e shoqëria. Dhuna në shkollë, abuzimi fizik dhe seksual, paragjykimet, shtatzënia e paplanifikuar dhe aborti kanë qenë dhe mbetin probleme reale të shoqërisë sonë Kosovare. Kjo shfaqje duke përfshirë të gjithë krijuesit e saj i dedikohet të gjithë të adoleshentëve të rënë në vitin 1998-1999 në luftën e fundit në Kosovë.

Shfaqja është mbajtur në Teatrin kombëtar të Kosovës nën regjinë e Zana Hoxha si dhe me aktorët/et: Hajat Toçilla, Valmir Krasniqi, Labinot Raci, Arta Muçaj, Shkëlzen Veseli, Semira Latifi, Shpetim Kastrati, Qëndresa Loki, Verona Koxha, Flamur Ahmeti, Armend Ballazhi dhe Muzikantët: Alzan Gashi, Arbër Salihu & Drin Tashi. Shfaqja është përcjellur nga 120 persona.

Gazeta Kultplus citon "Kjo shfaqje zgjon nevojën për të ngritur në diskutim tema të tilla "të ndaluara", për të folur për ndjenjat, seksin dhe përvojat e para teksa ato ndodhin, nevojën për t'i ditur të gjitha, për t'i kuptuar e për t'i përjetuar. Kjo shfaqje duke përfshirë të gjithë krijuesit e saj i dedikohet të gjithë të adoleshentëve të rënë në vitin 1998-1999 në luftën e fundit në Kosovë.

Kujtojmë që para pak ditësh shfaqja "Zgjidhja e Pranverës" u vlerësua si "Shfaqja më e mirë", duke u shpërblyer me çmimin "Grand Prix", në edicionin e katërmëdhjetë të ITF Skupi Festivali. Juria ka vlerësuar shfaqjen për shkak të konceptit të saj të fortë regjisorial dhe estetikës bashkëkohore teatrore, duke sjellë një "drejtim të ri" të shprehjes teatrore ballkanike, që është në hap me atë evropiane, duke vepruar në fushën e "teatrit total", duke përdorur muzikë, dramë, vallëzim dhe video, me aktrim që shtynjë kufijtë e zakonshëm, duke përfshirë edhe reagimin e audiencës"



Dita e fundit si dhe fundi i festivalit Femart ka përfunduar me një **After Party nga Semira Latifi – Vokal, Arbër Salihu – Kitarë, Drin Tashi – Bateri dhe Alzan Gashi – Piano**. Nën tingujt e mahnitshëm dhe nën shoqërimin e këngëve bluz/rok/pop nga Semira Latifi, pjesëmarrësit/et në këtë ndejë janë ndjerë të mirëseardhur të relaksuar dhe të bashkuar ndërmjet vete. Në këtë koncert prezent kanë qenë rreth 80 persona.



Radio K4 citon “Zana Hoxha, drejtoreshë e “FemArt” ka thënë për KALLXO.com se këtë vit ky festival u zhvillua pak më ndryshe, me më shumë sfida.” Ndryshimi ishte se këtë vit kishim më pak aktivitete në krahasim me vitet e kaluara, 27 nga 40. Me një pjesëmarrje më të madhe të artisteve/ëve dhe aktivisteve/ëve kosovarë e shumë pak nga rajoni. Gjithashtu, duke qenë se audienca ka qenë vetëm 40% e kapacitetit të lokacionit ku janë mbajtur aktivitetet, ne i kemi transmetuar performancat në Facebook në kohën e ngjarjes, që t’i japim mundësi publikut ta shijojë ngjarjen, për ata që nuk kanë mund të jenë pjesë e publikut live”, ka thënë Hoxha”

Gjithashtu për mbylljen e festivalit Femart ka shkruar edhe Insajder si në vazhdim: “E si të mbyllet më mirë FemArt 8-të, se me shfaqjen e Teatrit Kombëtar të Kosovës, fituese në festivalin ndërkombëtar “SkupiFest”, “Zgjimi i pranverës”, nën regjinë e Zana Hoxhës. Pas përfundimit të festivalit, drejtoresha e tij, Zana Hoxha, shpalosi sfidat nëpër të cilat është realizuar ky edicion. Po ashtu, Hoxha, ka treguar se sivjet FemArt, ishte nikoqir i katër premierave shfaqje dhe performanca me produksion të Artpolis, ku janë prezantuar krijimet origjinale të artisteve/ëve kosovarë”.

Shënim: Të gjitha aktivitetet që janë zhvilluar në kuadër të festivalit Femart janë mbajtur në përputhje me “Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19” të publikuar nga Ministria e Shëndetësisë, si dhe “Projektligji për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19”.

Është kërkuar nga të gjithë/a pjesëmarrëset/sit të respektojnë të gjitha masat për mbrojtjen nga Covid-19 duke mbajtur maskat dhe distancën e caktuar.

Edicioni i tetë i Festivalit FemArt është përkrahur nga:


Donatorët: Bashkimi European, Koalicioni i Kosovës për Pajtim, Ambasada e Suedisë në Kosovë/Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar - Sida, Fondi për Zhvillim Komunitar – CDF, Kvinna till Kvinna, UNFPA, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna e Prishtinës, Cfd, Ambasada Amerikane në Kosovë, Koalicioni K10.

Përkrahësit Institucional dhe medial: Teatri Oda, Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Fakulteti i Arteve - Universiteti i Prishtinës, Etno Fest, Hapu - Festivali i Artit në Hapësirë Publike, Kult-Plus, Selman Networks, Rikon, Frutomania, Dukagjini, mik-mik, T-shirt collective, Blue Taxi, Ymalko.

STATISTIKAT E FESTIVALIT FEMART

Pjesëmarrëset/it, vizitoret/ët, përcjellëset/it në rrjetet sociale, angazhimet ne rrjetet sociale


FEMART NË ETNO FEST 2 Aktivitete



DITA E PARË 2 Aktivitete



DITA E DYTË 4 Aktivitete




DITA E TRETË 4 Aktivitete




DITA E KATËRT 5 Aktivitete



DITA E PESTË 5 Aktivitete



DITA E GJASHTË 5 Aktivitete



TOTAL 27 Aktivitete





61
Posts

16.216
Organic reach

1008K
People Reached

39.828
Post Engagements

323
Page Likes



33
Posts

21,113
People reach

30.843
Impressions

GJINIA



71%
Gra



29%
Burra

MOSHA

0.8% 13-17

19% 18-24

45% 25-34

26% 35-44

6.8% 45-54

1.4% 55-64

1.2% 65+

TOP LOKACIONET

43% Prishtinë

6.4% Tiranë

3.9% Prizren

2.8% Ferizaj

Këtu mund të gjeni më shumë foto festivalin Femart:

Web: www.femart-ks.com

FB: [Femart](#)

IG: [femartkosovo](#)

TW: [FemArtKosovo](#)

YT: [Femart Festival](#)

SHTOJCA 1:

ARTIKUJT NGA MEDIA:

Gazeta Blic - Filmi “Adelina” nga Rita Krasniqi me një premierë të suksesshme në festivalin FemArt në Kosovë
<https://gazetablic.com/filmi-adelina-nga-rita-krasniqi-me-premiere-te-suk-sesshme-ne-festivalin-femart-ne-kosove/?fbclid=IwAR1hBjCptrXP4ML5T3iH-GwYAR3t8W7mrix-vWmKGLnnTAj86JldC848HsG4>

KosovaLive360: Festivali Femart 8 mbahet me 15-20 Tetor 2020
<https://www.kosovalive360.com/fstivali-femart-8-mbahet-me-15-20-tetor-2020/>

Observerkult: Femart 2020 mbahet nga 15 deri me 20 Tetor
<https://observerkult.com/femart-2020-mbahet-nga-15-deri-me-20-tetor/>

KultPlus: FemArt Festival vjen me edicionin e tetë për këtë vit, publikohen datat
https://www.kultplus.com/lajme/femart-festival-vjen-me-edicionin-e-tete-per-kete-vit-publikohen-datat/?fbclid=IwAR3azGVsnRTOApiB-VXA9_d8svjxl9E_GrXkNoN7ec3GaSKINIZhICiAARtE

Koha.net: “FemArt 2020” mbahet nga 15 deri më 20 tetor
https://www.koha.net/kulture/233344/femart-2020-mbahet-nga-15-deri-me-20-tetor/?fbclid=IwAR1GjSuhoEcAZ4ceXAsF2VhYiXP-g7vK4U2NwqyYFh4cXtxZ5W2NPcs1_BTA

RTK2: Programi I mengjesit – interview ne studio
<https://www.facebook.com/DobroJutroRTK2/videos/349286673110143/UzpfSTE4MDkxMDA2NTg6MTAyMTQyODY3Mjl2NDExNjY/>

Kids of Kosova: Agjenda

<https://www.facebook.com/KidsofKosova/posts/178820687146918>

Kids of Kosova: FemArt Festival - 8th edition from October 15 to 20 in Prishtina

https://kidsofkosova.net/femart-festival-edicioni-i-8-te-fillon-nga-15-20-tetor-ne-prishtine/?fbclid=IwAR0Zzyz2kXU_zxuna-MzB04nfhHocVEFubgpA7l30aZYhV7OGYrqAhgX6LA

KultPlus: Femart Festival – Me moton Solidaritet dhe Qëndrueshmëri fillon edicioni i tetë në Prishtinë

<https://www.kultplus.com/lajme/me-moton-solidaritet-dhe-qendrueshmeri-fillon-edicioni-i-tete-i-festivalit-femart/?fbclid=IwAR1loO92flyAx-UK4V8mDSAIRX8ixlcXh9fuBfZdz4byFNgbYkbE3Moz0iiQ>

Prishtina insight: Etno festi feston grate dhe diellin në 10 vjetorin e tij

<https://prishtinainsight.com/etno-fest-celebrates-women-and-the-sun-in-its-10th-year/?fbclid=IwAR1RO8DIU8z16NRPdW668p1y7yFOf7mR8e-KIL-pEET-fAwgkfSbmngxCHfh4>

Prishtina insight: Femart edicioni i 8-te, festoon Solidaritetin dhe Qëndrueshmërinë në kohëra sfiduese https://prishtinainsight.com/femarts-8th-edition-celebrates-resilience-and-solidarity-in-challenging-times/?fbclid=IwAR1alzcgIKN2r81jhrdO_RHhLSOMakDI5sGTI0mxSTjg-PexxLUKpc_WX1RA

Exit News.al – Solidariti dhe Qëndrueshmëria përmes festivalit për të drejtat e grave

https://exit.al/en/2020/10/16/solidarity-and-resilience-through-women-rights-festival/?fbclid=IwAR2Eb5ueKtQeuo6W1tuKE44yyYS_i-o-8Vam-Vi6lgz61mQNix5E_R1etwjw

Gazeta letrare

<https://www.facebook.com/gazetaletrare/photos/pcb.1232578940452135/1232578473785515>

Insajderi: FemArt, festivali që në kohë pandemie zgjati dorën e solidaritetit dhe qëndrueshmërisë

<https://insajderi.org/femart-festivali-qe-ne-kohe-pandemie-zgja-ti-doren-e-solidaritetit-dhe-qendrueshmerise/?fbclid=IwAR3pCjxekZxtU-bP-JeiTCKBt4BGbugK2KyykRK2rMQHbTsE1H3BrWunELI4>

Radio Kfor: Hapet aplikimi per festivalin Femart
<https://radiokfor.com/1/hapet-aplikimi-per-festivalin-femart/>

Kallxo.com: Mbyllet Festivali Femart 2020
<https://kallxo.com/lajm/mbyllet-festivali-femart-2020/>

RTV21: Sonte mbyllet festivali “Femart”
<https://www.youtube.com/watch?v=47cn4SLS69Y>

Kallxo.com: Hapet edicioni i 8-të il festivalit Femart 2020
<https://kallxo.com/kulture/hapet-edicioni-i-8-te-i-festivalit-femart-2020/>

Klan Kosova: Hapet FemArt festivali
<https://www.youtube.com/watch?v=CQ67yxxQZNk>

Kallxo.com: Këtë muaj mbahet edicioni i 8-të i festivalit ‘FemArt’
<https://kallxo.com/kulture/kete-muaj-mbahet-edicioni-i-8-te-i-festivalit-femart/>

Teatri Oda: FemArt Festivali – Edicioni i 8-të
<http://teatrida.com/en/miscellaneous/femart-festival---the-8th-edition-#.X5aRRdBKjIU>

KTV-Express: “Zgjimi i pranverës” rihap dyert e Teatrit Kombëtar të Kosovës
https://www.youtube.com/watch?v=OaMGsc59Lmc&feature=share&fbclid=IwAR1Z5IPgcQ6Brdb4M9AlqAAZ8ToM0xXJJXvPLi_WS-8nqfmzcp-aFfPMdso

KultPlus: “Spring Awakening” reopens the doors of the National Theater of Kosovo
<https://www.kultplus.com/teatri/teatri-kombetar-hape-dyert-per-publikun-me-premieren-e-shfaqjes-zgjimi-i-pranveres/?fbclid=IwAR1oxxoX2oqK-MKGy3DSh1SNZatjx7JM9pvZ5eDUtkf6pkJX8ifhSRNzjC9k>

RTK2: Zoe Gudovic – artistja flet për festivalin ndërkombëtar të Femart-it, e cila mbahet në Prishtinë, nga tetor 15 deri 20.
<https://www.facebook.com/1421303494830897/videos/679038323036385>

Klan Kosova: Çfarë aktivitete vazhduan dy ditët e fundit në festivalin “FemArt”

<https://www.facebook.com/OraePasditesOfficial/videos/279510463322847>

RTK Live: Përfundoi edicioni i 8-tëi “Femart” festivalit <https://www.rtklive.com/rtk2/?id=6&r=49327&fbclid=IwAR0POEnXPcAZ4Pul-FmG80X-cpp-2J7A5SC8zDeyKFeV9BdEfnPikgNwnvLQ>

Gazeta Scanner: Regjisoria Rita Krasniqi shpalos në ekran vështirësitë e komunitetit LGBTQI+ me filmin e saj ‘Adelina’ https://gazetascanner.com/regjisoria-rita-krasniqi-shpalos-ne-ekran-veshtire-site-e-komunitetit-lgbtqi-me-filmin-e-saj-adelina/?fbclid=IwAR2j9uUGXqPoms5L-gzuRdaJcJNkFSeG2cd20wTDgGKo61rc7kYQHa7WP_c

Koha.net: “FemArti” në transformim, përballë sfidave me art e aktivizëm aktivism https://www.koha.net/kulture/242177/femarti-ne-transformim-perbal-le-sfidave-me-art-e-aktivizem/?fbclid=IwAR14pYs-9YleoaVJ_thdJGUUbD49uD6L-65R6vJNNUzW4gwID_-U-9XfnWWU

KultPlus: Arti dhe solidariteti bashkoi gratë në kohë pandemie, si rezultat sollën dy premiera në FemArt

https://www.kultplus.com/teatri/arti-dhe-solidariteti-bashkoi-grate-ne-kohë-pandemie-si-rezultat-sollen-dy-premiera-ne-femart/?fbclid=IwAR1yCMP_2Ex-QLBhrLI1StRjhsvoiuQzp6jZE7ba4WRhUyYtPfhO6iarwrU

Koha.net: “Silver Boom” pushton hapësirën publike me lirinë e grave <https://www.koha.net/kulture/241944/silver-boom-pushton-hapesiren-publike-me-lirine-e-grave/?fbclid=IwAR2iQuP5FYiyljAYXzIDwyLLYLgz7t-OpMswJzmPpwIJ1vFen4S5siCXuHoY>

Koha.net “Ti, jam unë” e “Çfarë duan burrat” në përplasje këndvështrimesh gjinore

https://www.koha.net/kulture/242000/ti-jam-une-e-çfare-duan-burrat-ne-per-plasje-kendveshtrimesh-gjinore/?fbclid=IwAR2t73f23ha4HIX1QmIfv24WE-3ZLSepaTt0Q09ZrYFB-x-ytHotsKp_kmeo

Insajderi: Femart 8-të publikon raportin “Drejt Solidaritetit dhe Bashkëpunimit” – me një konferencë ndërkombëtare shpalosi të arriturat e grave dhe atë se çka duhet bërë tutje

<https://insajderi.org/femart-8-te-publikon-raportin-drejt-solidaritetit-dhe-bashkepunimit-me-nje-konference-nderkombetare-shpalosi-te-arriturat-e-grave->

[dhe-ate-se-cka-duhet-bere-tutje/?fbclid=IwAR13sQIHX0tHyvCDocrN3VfK1ceK-jzqlquJLBkEYfBpT1-BSqpBVW2Nw7jU](https://www.facebook.com/Koha.net/videos/1015644448547)

Koha.net: “FemArti” si provokim për solidaritet dhe qëndrueshmëri

<https://www.koha.net/kulture/241666/femarti-si-provokim-per-solidaritet-dhe-qendrueshmeri/?fbclid=IwAR0z0CJVj3fDsjzG0byz2vgmgEJNAEgwSX-PaE8UbNp9qg8oaw0-nV09Ej6M>

Koha.net: Premiera e dans performances “ Lidhme mua” in “Femart” festival

https://www.youtube.com/watch?v=_hq6Z6Aaprw&feature=youtu.be&fbclid=IwAR1EX5BBPFUtt-JgreNNIVGxRGHb8fU5P3vpVI3_w9DBljINGYaUX9QxfIA

Klan Kosova: Ora shtatë – mysafiret: Arlinda Morina - Liki, regjisore dhe Uresa Ahmeti <https://www.facebook.com/Ora7Official/videos/344598946867305>

ABC News. AI - Gruaja trajtohet ende si objekt

<https://www.youtube.com/watch?v=NrGXQLlawbl&fbclid=IwAR-2AeSN9cP9TEN6gJorvw5C98iLfkobMxsngDZel-Hbjgql0Wf0lnisJiwg>

TV Dukagjini – Emisioni “Reload”

<https://www.facebook.com/dukagjinireload/videos/369075604448547>

Klan Kosova: Emisioni i mëngjesit - Natyrë Kallaba, premiera e shfaqjes “Ti, jam unë” në FemArt Festivalin

<https://www.facebook.com/Ora7Official/videos/781444105980160>

T7: TV emisioni #gjesi - “Femart 2020” – Solidariti and Qëndrueshmëria

<https://video.gjirafa.com/gjesi/femrat-2020-solidariteti-dhe-qendrueshmeria?fbclid=IwAR11DynrqA6Ag-TzCFZrzb4CGdRnFM431msNEx6ibsadnftletU8jghGa0>

TV21: TV emisioni i mëngjesit – Edicioni i 8-të i “FemArt Festival” fillon sonte

<https://www.facebook.com/RTV21live/videos/3019077414994029>

Kanal 10: TV emisioni “Pasdite”

<https://www.facebook.com/Kanal10.live/videos/1323947737969825>

KTV – Express – Çka përfshin edicioni i 8-të i “Femart” festivalit?

<https://www.youtube.com/watch?v=g5oExEZ0Y0E&feature=youtu.be&fbclid=IwAR2bNBIBcQVXIFhV5zWBX1lISImz4oYhbuF3Klu8VB-aM1gM8qwMlotozgo>

ORGANIZUAR NGA / ORGANIZED BY:



MBËSHTETUR NGA / SUPPORTED BY:



